

NJOFTIM PËR TË DREJTAT E PUNËTORËVE

Sipas Earned Sick Time Act (Paid Sick Leave Law) (Aktit për Kohën e Fituar të Pushimit Mjekësor në bashkinë e New York-ut (Ligjin mbi pagesën e pushimit mjekësor), disa punëdhënës janë të obliguar që tu japin pushim mjekësor punëtorëve të tyre. Vizito faqen nyc.gov/PaidSickLeave për të mësuar se cilët punëtorë janë të mbuluar me këtë ligj.

Punëdhënësit me pesë apo më shumë punëtorë të cilët punojnë më shumë se 80 orë brenda një viti kalendarik në Qytetin e New York-it janë të obliguar që tu japin punëtorëve të tyre pushim mjekësor me pagesë. Punëdhënësit me më pak se pesë punëtorë janë të obliguar që tu japin punëtorëve të tyre pushim mjekësor pa pagesë.

Punëdhënësit të cilët kanë të punësuar një apo më shumë punëtorë vendorë të cilët janë në marëdhënje pune prej së paku një viti dhe të cilët punojnë më shumë se 80 orë brenda një viti kalendarik, poashtu janë të obliguar tu japin këtyre punëtorëve pushim mjekësor me pagesë.

Në bazë të ligjit, punëdhënësit të cilët janë të obliguar tu japin punëtorëve të tyre pushim mjekësor me pagesë, duhet ti pajisin të gjithë punonjësit e ri dhe ata ekzistues me një njoftim me shkrim në lidhje me këtë të drejtë të tyre, para datës 1 Maj, 2014.

KENI TË DREJTË PËR PUSHIM MJEKËSOR, TË CILIN PUSHIM MUND TA SHFRYTËZONI PËR TRAJTIM DHE KUJDESJE NDAJ VETEVETES APO NDAJ NDONJË ANËTARI TË FAMILJES SUAJ.

SASIA KOHORE E PUSHIMIT MJEKËSOR:

- Punëdhënësi juaj është i obliguar që tu jap deri në 40 orë pushim mjekësor për çdo vit kalendarik. Viti kalendarik i punëdhënësit tuaj është:

Fillimi i Vitit Kalendarik: _____ Fundi i Vitit Kalendarik: _____

- Punëtorët vendorë: Punëdhënësi juaj është i obliguar që tu jap dy ditë pushim mjekësor me pagesë, që është një kohë shtesë përveç tri ditëve të pushimit mjekësor me pagesë që e keni të garantuar sipas New York State Labor Law. Shko tek faqja labor.ny.gov dhe kërko "Domestic Workers' Bill of Rights" ("Punëtorët Vendorë" Projektligji mbi të Drejtat"), për informata shtesë.

NORMA E AKUMULIMIT TË ORËVE TË PUSHIMIT MJEKËSOR:

- Për 30 orë pune ju do të fitoni një orë pushim mjekësor, që do të thotë se ju do të grumbulloni maksimum 40 orë të pushimit mjekësor për një vit kalendarik.
- Punëtorët Vendorë: Sipas ligjit të Qytetit, ju duhet të keni punuar për të njejtin punëdhënës për së paku një vit në mënyrë që të fitoni dy ditë të pushimit mjekësor me pagesë. DCA do ju pajisë me informata në lidhje me pushimin e akumuluar tek faqja nyc.gov/PaidSickLeave.

DATA E FILLIMIT TË AKUMULIMIT:

Ju do të filloni të akumuloni pushim mjekësor duke filluar nga data 1 Prill, 2014, apo qysh nga dita e parë e punësimit.

Përjashtim: Nëse jeni të mbuluar nga programi i marrëveshjes të ujdive kolektive që është në fuqi me datë 1 Prill, 2014, sipas ligjit të Qytetit, ju do të filloni të akumuloni pushim mjekësor duke filluar nga data kur të mbaron programi i marrëveshjes së ujdive kolektive.

DATA KUR MUND TË FILLONI TA SHFRYTËZONI PUSHIMIN MJEKËSOR:

- Ju mund të filloni ta shfrytëzoni pushimin mjekësor me datë 30 Korrik, 2014 ose pas 120 ditësh nga data e fillimit të punës.
- Punëtorët Vendorë: DCA do ju pajisë me informata në lidhje me kohën kur mund të filloni ta shfrytëzoni pushimin mjekësor tek faqja nyc.gov/PaidSickLeave.

ARSYET E PRANUARA QË MUNDËSOJNË SHFRYTËZIMIN E PUSHIMIT MJEKËSOR:

Keni të drejtë të shfrytëzoni pushimin mjekësor nëse:

- Keni sëmundje fizike ose mentale, lëndime, apo ndonjë problem tjetër shëndetësorë; keni nevojë për një diagnozë mjekësore, keni nevojë për trajtim të ndonjë sëmundje fizike ose mentale, të ndonjë lëndimi apo gjendje tjetër shëndetësore; keni nevojë për preventivë mjekësore.
- Nëse jeni i detyruar të kujdeseni për ndonjë anëtar të familjes suaj që ka nevojë për ndonjë shërbim mjekësorë dhe diagnozë medikale, për ndonjë përkujdesje apo trajtim të ndonjë sëmundje fizike apo mentale, të ndonjë lëndimi apo të një gjendje shëndetësore, apo që ka nevojë për ndonjë preventivë mjekësore.

- Nëse biznesi i punëdhënësit tuaj mbyllet për shkak të ndonjë emergjence të shëndetit publik, apo nëse keni nevojë të kujdeseni për ndonjë fëmijë tuajin, shkolla e të cilit, apo qendra e kujdesit shëndetësor, janë mbyllur për shkak të ndonjë emergjence të shëndetit publik.

ANËTARËT E FAMILJES:

Ligji i identifikon si anëtarë të familjes personat siq vijon:

- Fëmijët
- Nipërit dhe Mbesat
- Bashkëshortët
- Partnerët familjar
- Prindërit
- Gjyshërit
- Fëmijët dhe prindërit e bashkëshortit të punëtorit apo partnerit familjar
- Motrat dhe vëllezërit (gjysmë motrat dhe gjysmë vëllezërit, të adoptuarit, apo motrat dhe vëllezërit nga njerku apo njerka)

NJOFTIM PARAPRAK:

Nëse parashikohet ndonjë nevojë e arsyeshme, atëherë punëdhënësi juaj mund të kërkojë nga ju që të aplikoni për pushim mjekësor paraprakisht, me saktë 7 ditë para datës së fillimit të pushimit mjekësor. Por nëse paraqitet nevoja në mënyrë të pa parashikueshme, atëherë punëdhënësi juaj mund të kërkojë që të aplikoni për pushim mjekësor sa më shpejt që është e arsyeshme

VËRTETIMI:

Punëdhënësi juaj mund të kërkojë vërtetim nga shërbyesi i licensuar mjekësor nëse ju keni përdorë pushim mjekësor më shumë se tri ditë pune të njëpasnjëshme. Paid Sick Leave Law (Ligji mbi Pushimin Mjekësor me Pagesë) i ndalon punëdhënësit që të kërkojë nga shërbyesi mjekësor arsyen e ekzaminimit dhe gjendjen tuaj shëndetësore. Sidoqoftë, informata të tilla mund të kërkojnë në raste tjera të përcaktuara me ligj.

PUSHIMI MJEKËSOR I PAPËRDORUR:

Ju mund ti bartni deri në 40 orë të pushimit mjekësor që nuk i keni shfrytëzuar në vitin pasues kalendarik. Sidoqoftë, punëdhënësi juaj është i obliguar të ju lejoj ti shfrytëzoni vetëm 40 orë pushim mjekësor brenda një viti kalendarik.

JU E MBANI TË DREJTËN TË MOS I KOMPENZONI APO TË MOS I SHPAGUANI DITËT E PUSHIMIT MJEKËSOR QË MUND TË KËRKOHET NGA PUNËDHËNËSI JUAJ.

Punëdhënësi juaj nuk ka të drejtë të kërkojë nga ju kompensim apo shpagim nëse ju:

- Kërkoni shfrytëzimin e pushimit mjekësor.
- Paraqitni ankesë tek DCA për ndonjë shkelje eventuale të ligjit.
- Komunikoni me persona tjerë, duke përfshirë bashkëpunëtorët, në lidhje me ndonjë shkelje eventuale të ligjit.
- Merrni pjesë në ndonjë procedurë gjyqësore në lidhje me ndonjë shkelje eventuale të ligjit.
- Informoni një person tjetër për të drejtat e tij/saja.

Kompensim ose shpagim përfshihet çdo kërcënim, masë disiplinore, shkarkim, ulje të pozitës, suspendim, apo reduktim të orarit të punës, apo çdo akt tjetër në dëm tuajin në rastin kur tentoni apo shfrytëzoni të drejtën tuaj të garantuar me ligj.

JU KENI TË DREJTË TË PARAQITNI ANKESË

Ju mund të paraqitni ankesë tek DCA). Për të marrë formën e ankesës, shko tek faqja nyc.gov/PaidSickLeave ose kontakto **311** (212-NEW-YORK jashtë NYC).

DCA do të bën një hetim dhe do të bashkëpunon me punëdhënësin për të zgjidhur ankesën tuaj. DCA do ta mban identitetin tënd konfidencial, dhe do ta bën publike vetëm në rast se një gjë e tillë është e domosdoshme për ti zhvilluar hetimet, nëse është e nevojshme për zgjidhjen e kontestit, ose nëse kjo gjë kërkohet nga ligji.

Rruaje nga një kopje të çdo dokumenti të cilat tregojnë sasinë e orëve të pushimit mjekësor, kohës së akumuluar dhe asaj të shfrytëzuar.

Shënim: Earned Sick Time Act (Akti për Kohën e Fituar të Pushimit Mjekësor) përcakton kërkesat minimale për pushim mjekësor. Politikat e punëdhënësit tuaj në lidhje me pushimin mjekësor mund tashmë të jenë në përputhje me kërkesat e ligjit, dhe ndoshta mund ti kenë tejkaluar ato.

Ju keni të drejtën për një njoftim të tillë të shkruar në gjuhën angleze, dhe, nëse është e disponueshme në webfaqen e DCA, edhe në gjuhën e tyre amëtare.

Për më shumë informata, duke përfshirë edhe Pyetjet më të Shpeshta, shko tek faqja nyc.gov/PaidSickLeave ose thirr në numrin **311** dhe kërko informata në lidhje me Pushimin Mjekësor me Pagesë.



Bill de Blasio
Mayor

Consumer
Affairs

Lorelei Salas
Commissioner